

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA** si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja individuale Suzana Çerkini me sekretaren juridike Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit N.S nga Prishtina, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.977/2013 të datës 25.02.2015, pas seancës se shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 23.05.2018 në praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Gashi, të pandehurit N.S, të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**I pandehuri N.S**, i biri i N. dhe nënës F. e vajzërisë B. i lindur me ..., në P. me vendbanim Rr "A.H" nr., afër T.Gj, P, ka të kryer shkollën e mesme, punon me reklama (marketing), i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr. Personal...,

## ËSHTË FAJTOR

**Sepse**, me datën 31.08.2018 rreth orës 16:20, në rrugën magjistrale Fushë Kosovë Prishtinë, gjate një kontrole rutinore policia e ka ndaluar veturën e markës "VW" kombi, ngjyre e kuqe me tabela të regjistrimit..., të cilin e drejtonte i pandehuri N.S dhe, gjate kontrollit i është gjetur një elektroskok 5000 W, i tipit 800, të cilën armë i pandehuri e kishte mbajtur në pronësi dhe kontrole në kundërshtim me ligjin, ku dhe i është sekuestruar nga policia,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248 par.4, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

## **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe

## **DËNIM PLOTËSUES**

**KONFISKOHET** përherë: një elektroshok 5000 W, precizuar si në vërtetimin për konfiskimin e armatimit dhe municionit, nr. 2013-AE-01219 të datës 31.08.2013,

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.977/2013 të datës 25.02.2015 ka akuzuar N.S, për shkak të veprës penale Mbajtja, në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti seancë të shqyrtimit fillestar me datë 23.05.2018, në të cilën i pandehuri N.S, duke qenë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimi të fajësisë, vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, deklaroi se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë vullnetarisht pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me faktet dhe provat që mbështetet aktakuza andaj, mbi këtë bazë i propozon gjykatës që të nxjerrë aktvendim me të cilën do t'a aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Pas pranimit të fajsisë dhe pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata duke vlerësuar se pranimi i fajsisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë bindëse dhe të vullnetshme ka pranuar fajsinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimit të fajsisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, e aprovoi pranimin e fajsisë nga i pandehuri për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoi se meqenëse i pandehuri ka pranuar fajsinë, dyshimi i bazuar mire se i njëjti ka kryer këtë vepër penale vërtetohet në seancën e shqyrtimit fillestar me pranimin e fajsisë nga i pandehuri andaj, i propozoi gjykatës që të njëjtin t'a shpall fajtor dhe t'a dënoj sipas ligjit, ndërsa propozon që me rastin e matjes së dënimit ta këtë parasysht si rrethane lehtësuese pranimin e fajsisë nga i pandehuri dhe pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale.

I pandehuri N.S në fjalën përfundimtare theksoi se ndihet i penduar për veprën e kryer, dhe se deri më sot asnjëherë nuk ka kryer vepër tjetër penale. I njëjti premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale dhe kërkoi nga gjykata një dënim më të butë meqenëse mban dy familje sepse babai i ka vdekur, andaj ka lutur gjykatën të këtë parasysht edhe këtë rrethanë.

Gjykata, pas aprovimit të pranimit të fajsisë së të pandehurit, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve nga fjala e tyre përfundimtare si dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit si, rrethanat lehtësuese, pranimin e fajsisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, shprehjen e keqardhjes dhe pendimit për veprën e kryer, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj, të njëjtit i shqiptoi dënim burgimi, të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngajshme.

Vendimin për konfiskimin e sendit, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.102/15 me datë 23.05.2018**

**Zyrtare ligjore,  
Albulena Ademi**

---

**Kryetare e trupit gjykues-gjyqtare,  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.